



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1219/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Hib Petrol shpk, me nr. Biznesi 70249534, me seli ne Ferizaj fshati Talinovc i Muhaxherëve, ndaj debitorit Komuna e Ranillugut, me seli ne Ranillug, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkalles se Parë KPPP.nr.9/2022 dt.30.06.2023, me datën 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Hib Petrol shpk, me nr. Biznesi 70249534, me seli ne Ferizaj fshati Talinovc i Muhaxherëve, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkalles se Parë, KPPP.nr.9/2022 dt.30.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkalles se Parë, me aktvendimin KPPP.nr.9/2022 dt.30.06.2023, ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Ranillugut, me seli ne Ranillug ndërsa ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.595/14 dt.17.12.2014 te lejuar nga Përmbaruesi Privat Drestan Bujupaj, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditorit përmes përfaqësuesit te autorizuar avokat Arianit Koci dhe avokat Granit Vokshi, për shkak te shkeljes esenciale te dispozitave procedurale dhe shkeljes se ligjit material, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë ne tërësi dhe aktvendimin e atakuar ta anuloj, urdhri përmbarimor te mbetet ne fuqi ndërsa te obligohet debitori te paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Dhoma e Shkalles se Dytë, e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Hib Petrol shpk, me nr. Biznesi 70249534, me seli ne Ferizaj fshati Talinovc i Muhaxherëve, me datën 12.12.2014, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit Komuna e Ranillugut, me seli ne Ranillug, në bazë të dokumentit të besueshëm–Faturave nr.31012011123 dt.31.01.2011, 28022011115 dt.28.02.2011, 30042011078 dt.30.04.2011, 31052011071 dt.31.05.2011. Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj nga Prishtina, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.595/14

dt.17.12.2014, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të ofrimit të shërbimeve për furnizim me derivate të naftës të paguaj shumën prej 1,444.47 euro si edhe shpenzimet e tjera të procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrimit përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 26.12.2014, me pretendimin se nuk është i detyruar të paguaj sepse Komuna e Ranillugut nuk kishte të nënshkruar një Kontratë për furnizim me karburante me Hib Petrolin por Ministria e Pushtetit Lokal ka pasur obligim të paguaj mbushjen me derivate nga Hib Petrol, furnizimin me karburante të automjeteve të komunës, i kërkon shpenzimet.

Kreditori me datën 13.02.2015, ka ushtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, me pretendimin se nga Janari 2011 të gjitha shpenzimet e transportit përfshirë edhe furnizimin me derivate do ta bëjë vet Komuna e Ranillugut duke marrë parasysh që komuna është e konstituuar dhe funksionalizuar, andaj kreditori kërkon nga komuna e Ranillugut përmbushjen e detyrimit sipas faturave.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.9/2022 dt.30.06.2023, me të cilin ka pranuar prapësimin e debitorit si të bazuar duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Gjykata bazuar në shkresat dhe provat në lëndë si dhe sugjerimet e Gjykatës së Apelit, referuar edhe dispozitave ligjore nëni 29 par.3 dhe nëni 37 i LPP ka gjetur se kreditori nuk është i autorizuar që të kërkojë përmbarimin nga ana e debitorit Komuna e Ranillugut sepse faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi burojnë nga Kontrata e lidhur mes kreditorit dhe debitorit Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ndërsa në mbështetje të kësaj vet faturat si debitor evidentojnë MAPL. Gjykata arsyeton se fakti se debitori është marrësi i shërbimeve si në fatura nuk e bënë atë debitor përderisa lidhur me këto shërbime kreditori ka lidhur marrëveshje me MAPL. Gjykata vlerësoj shkresën zyrtare të datës 13.12.2010 përmes së cilës Qeveria e Republikës së Kosovës-MAPL, ka njoftuar kryetarin e Komunës së Ranillugut se nga 1 Janari 2011 shpenzimet që përfshijnë sigurimin e veturave, servisimin e veturave dhe furnizimin me derivate kalojnë në kompetencë të vet komunave të reja të cilat do të kenë vijë të veçante buxhetore por që nga Marrëveshja për vazhdimin e Kontratës dt.30.11.2011 e lidhur mes MAPL dhe kreditorit, rezulton se palët janë pajtuar që të vazhdohet marrëveshja për furnizim me derivate deri me dt.02.12.2012, andaj me vet faktin se kreditori ka vazhduar kontratën me MAPL ka qenë njoftuar që detyrimet që burojnë nga furnizimi me derivate për Komunën e Ranillugut vazhdon të këtë bartë MAPL. Gjykata ka marrë për bazë vërejtjet e Gjykatës së Apelit në aktvendimin Ac.nr.4641/17 dt.15.01.2018 por meqë kreditori rezulton të mos jetë i autorizuar që borxhin që rrjedh nga këto fatura të kërkojë nga debitori vlerësoj se nuk është e nevojshme hapja e një seance dëgjimore për shkak se e njëjta nuk mund të ndikojë në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktvendimi.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim konform dispozitave konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të

dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë përkitazi çështjes konkrete e pranon në tërësi sepse mbi bazën e fakteve dhe shkresave në lende i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Kjo gjykatë analizon shkresën zyrtare të datës 13.12.2010 të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës –Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ua ka dërguar Kryetarëve të Komunave si Graçanicë, Ranullug, Kllokot dhe Partesh, nga e cila rezulton se nga 1 Janari 2011 shpenzimet lidhur me sigurim, servisim, furnizim me derivate për vetura, pagesa të ndryshme si në këtë shkresë kalojnë në kompetencë të vet komunave të reja të cilat do ta kenë vijën e veçantë buxhetore sikurse të gjitha Komunitet tjerë. Mirëpo vlerëson se nga Marrëveshja për Vazhdim të Kontratës dt.30.11.2011 të lidhur me MAPL dhe Hib Petrol, për furnizim me derivate të naftës nr.ref.212 10 002 121, rezulton se palët janë pajtuar që të vazhdojnë furnizimet e cekura si në kontratë deri me datën 02.12.2012 ashtu siç është përcaktuar në kushtet e përgjithshme të kontratës bazë, e ndërsa nga kushtet e veçanta të Kontratës nuk është precizuar saktë se Komunitet do të paguaj detyrimet për furnizimet e marra, ashtu që edhe për këtë gjykatë rezulton se fakti që MAPL dhe kreditori Hib Petrol shpik kanë vazhduar kontratën për furnizim me derivate e në rastin konkret për Komunitet e Ranillugut, MAPL ka në detyrim pagesat që rrjedhin nga kjo kontratë. Kjo gjykatë ka analizuar pretendimin e kreditorit se aktvendimi i atakuar nuk ka qenë në harmoni me rekomandimet e Gjykatës së Apelit sepse gjykata e shkallës së parë ka qenë dashtë që ta kthej në plotësim dhe precizim propozimin e kreditorit në lidhje me veprimet nevojshme por këtë pretendim e konsideron të paqëndrueshëm sepse gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar fillimisht legjitimitetin e kërkesës së kreditorit ndaj debitorit nga e cila me pastaj rrjedh edhe obligimi apo jo i përmbushjes së detyrimit si në propozimin për përmbarim, po ashtu kjo gjykatë analizoi edhe pretendimet tjera por vlerësoi se janë të pabazuara dhe jo relevante për një vendosje ndryshe dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1219/23, me datë 15.03.2024

Gjyqtari,  
Dren Rogova